

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT, AFATEVE DHE PROCEDURËS SË KONKURRIMIT PËR DHËNIEN ME QIRA TË ZONËS SË GJUETISË, MBARËSHTIMIT DHE RIPOPULLIMIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka për qëllim krijimin e një kuadri të plotë dhe të qartë rregullator për përcaktimin e dokumentacionit, afateve dhe procedurave që ndiqen në procesin e konkurrimit publik për dhënie me qira të zonave të gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit të faunës së egër. Nëpërmjet këtij akti synohet të standardizohet dhe të unifikohet praktika administrative në nivel vendor, duke siguruar që procesi i për zgjedhjes së subjekteve për menaxhimin e këtyre zonave të zhvillohet në mënyrë transparente, të drejtë dhe konkurruese.

Konkretisht, ligji nr. 89/2025 “Për Gjuetinë”, parashikon rregullat dhe kërkesat për zhvillimin e gjuetisë së qëndrueshme, si një veprimtari tradicionale, sportive, çlodhëse, si edhe rregullat për monitorim dhe kontroll për të garantuar që parimet për gjuetinë të zbatohen nëpërmjet institucioneve përgjegjëse duke mbrojtur faunën e egër dhe ruajtjen e biodiversitetit. Në këtë kuadër, projektvendimi vjen si një akt në zbatim të këtij ligji, duke detajuar procedurat dhe mekanizmat konkret për administrimin e zonave të gjuetisë.

Projektvendimi synon gjithashtu të garantojë një përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe të biodiversitetit. Në këtë kuadër, ai vendos rregulla të qarta për menaxhimin e zonave të gjuetisë, duke përfshirë detyrimet për mbarështimin dhe ripopullimin e llojeve të faunës së egër, si dhe masat për mbrojtjen e habitateve natyrore.

Relacion shpjegues për projektvendimin: “Për përcaktimin e dokumentacionit, afateve dhe procedurës së konkurrimit për dhënie me qira të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit”

Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektvendimi janë:

- krijimi i një procedure të standardizuar dhe të kontrolluar për dhënien me qira të zonave të gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit;
- garantimi i transparencës dhe barazisë së trajtimit për të gjithë subjektet pjesëmarrëse në konkurrim;
- përzgjedhja e subjekteve me kapacitetet e duhura teknike, profesionale dhe financiare për menaxhimin efektiv të zonave;
- sigurimi i menaxhimit të qëndrueshëm të faunës së egër, duke respektuar balancat ekologjike dhe kuotat e lejuara të gjuetisë;
- mbrojtja e biodiversitetit dhe e habitateve natyrore nga dëmtimet dhe shfrytëzimi i pakontrolluar;
- forcimi i mekanizmave për parandalimin e gjuetisë së paligjshme dhe aktiviteteve të tjera që çenojnë mjedisin;
- rritja e përgjegjshmërisë së subjekteve që administrojnë zonat e gjuetisë;
- nxitja e zhvillimit ekonomik lokal përmes përdorimit të qëndrueshëm të këtyre zonave dhe krijimit të mundësive për investime dhe punësim.

Në tërësi, projektvendimi synon të vendosë një balancë të qëndrueshme ndërmjet shfrytëzimit ekonomik të zonave të gjuetisë dhe nevojës për mbrojtjen e mjedisit, duke kontribuar në ruajtjen afatgjatë të pasurive natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim del në zbatim të nenit 27, të Ligjit nr. 89/2025 “Për gjuetinë”, me propozimin e ministrit përgjegjës për gjuetinë, nuk është parashikuar në Programin i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve. Ky projektakt vjen në zbatim të pikës 4 të nenit 27, të ligjit nr. 89/2025, datë 12.12.2025, “Për Gjuetinë”.

Gjithashtu, është në përputhje me Programin politik të qeverisë shqiptare për ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit të faunës së egër me qëllim organizimin e një procesi të gjuetisë në mënyrë të qëndrueshme.

Relacion shpjegues për projektvendimin: “Për përcaktimin e dokumentacionit, afateve dhe procedurës së konkurrimit për dhënien me qira të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit”

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Hartimi dhe miratimi i këtij projektvendimi vjen si një domosdoshmëri për të plotësuar kuadrin rregullator në zbatim të ligjit nr. 89/2025 “Për gjuetisë”, duke adresuar boshllëqet ekzistuese në procedurat për dhënien me qira të zonave të gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit.

Projektvendimi për përcaktimin e dokumentacionit, afatet, kriteret dhe procedurën e konkurrimit publik për dhënien me qira të zonave të gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit synon të krijojë një kuadër të qartë, transparent dhe të zbatueshëm për dhënien me qira të zonave të gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit, duke garantuar një menaxhim të qëndrueshëm të faunës së egër dhe përfshirjen e aktorëve lokalë.

Ndër përparësitë kryesore është vendosja e rregullave të standardizuara për konkurrimin publik, rritja e kontrollit institucional dhe formalizimi i aktivitetit të gjuetisë, duke kontribuar në mbrojtjen e biodiversitetit dhe në zhvillimin ekonomik lokal përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Projektvendimi adreson disa problematika të identifikuara në praktikë, si:

- mungesa e një procedure të unifikuar për dhënien me qira të zonave të gjuetisë;
- nivel i ulët i kontrollit mbi zbatimin e detyrimeve nga subjektet që administrojnë zonat;
- rreziku i shfrytëzimit të pakontrolluar të faunës së egër dhe cenimit të habitateve natyrore;
- mungesa e kriterëve të detajuara për vlerësimin e ofertave dhe për zgjedhjen e fituesit;
- dobësi në mekanizmat e përgjegjshmërisë dhe ndëshkimit në rast shkeljesh.

Efektet e pritshme të projektvendimit përfshijnë përmirësimin e menaxhimit të zonave të gjuetisë, rritjen e të ardhurave për njësitë vendore dhe ekonominë rurale, si dhe forcimin e mekanizmave të mbrojtjes së faunës përmes mbarështimit, ripopullimit dhe kontrollit të presionit mbi speciet. Në

Relacion shpjegues për projektvendimin: “Për përcaktimin e dokumentacionit, afateve dhe procedurës së konkurrimit për dhënien me qira të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit”

afat të mesëm dhe të gjatë, pritet një rritje e ndërgjegjësimit mjedisor, një administrim më efikas i territorit dhe një integrim më i mirë i praktikave të qëndrueshme në politikat e menaxhimit të burimeve natyrore.

Për sa më sipër, miratimi i këtij projektvendimi del si domosdoshmëri për lehtësimin e strukturave menaxhuese, si edhe një qeverisje më të mirë dhe të drejtë të zonave të gjuetisë, duke patur si pritshmëri për të ardhmen një administrim më të mirë dhe mundësimin e efekteve financiare pozitive në këtë sektor.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës, në pikën 4 të nenit 27, të ligjit nr. 89/2025, datë 12.12.2025, “Për Gjuetinë” dhe është në harmonizim me kuadrin ligjor në fuqi për gjuetinë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE-së (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi i propozuar nuk synon të përafrojë asnjë dokument të *acquis* e BE-së, pasi është akt që bazohet në legjislacionin e brendshëm të vendit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Sa i përket formës së projektvendimit, sqarojmë se projektvendimi është i strukturuar në 15 pika si më poshtë:

Pika 1, trajton detyrimin e njëjësive të vetëqeverisjes vendore që, pas shpalljes së zonave për gjueti, mbarështim ose ripopullim, të fillojnë brenda një afati të caktuar procedurën për dhënien e tyre me qira nëpërmjet një procesi konkurrimi publik.

Pika 2, përcakton detyrimin e kryetarit të bashkisë për ngritjen me urdhër të një komisioni, i cili ngarkohet me ndjekjen dhe administrimin e procedurave të konkurrimit publik.

Pika 3, jep rregullat për publikimin e shpalljes për dhënien me qira të zonave të gjuetisë, mbarështimit ose ripopullimit, afatet e publikimit, si dhe

Relacion shpjegues për projektvendimin: “Për përcaktimin e dokumentacionit, afateve dhe procedurës së konkurrimit për dhënien me qira të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit”

elementet e detyrueshme që duhet të përmbajë njoftimi për zhvillimin e procedurës së konkurrimit publik.

Pika 4, parashikon detyrimin e çdo subjekti pjesëmarrës për të paraqitur dokumentacionin që vërteton përmbushjen e kritereve ligjore për marrjen në përdorim të zonave përkatëse.

Pika 5, përcakton përmbajtjen e kërkesës për pjesëmarrje në konkurrim, përfshirë të dhënat e subjektit, ofertën financiare dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe kategorinë e zonës për të cilën aplikohet.

Në pikën 6, listohet dokumentacioni i detyrueshëm që duhet të paraqitet nga subjektet pjesëmarrëse, përfshirë dokumentet identifikuese, regjistrimin, vërtetimet gjyqësore dhe tatimore, planet e biznesit dhe të menaxhimit, kapacitetet teknike, përvojën profesionale dhe deklaratën e përgjegjësisë ligjore.

Pika 7, parashikon që hapja dhe shqyrtimi i kërkesave dhe ofertave kryhet nga komisioni në datën dhe vendin e përcaktuar në njoftimin përkatës.

Në pikën 8 dhe 9, përcaktohet mënyra e vlerësimit të ofertave nga komisioni përmes sistemit të pikëzimit, renditjen e konkurrentëve sipas pikëve të fituara, si dhe detyrimin për hartimin e raportit të vlerësimit që i paraqitet kryetarit të bashkisë brenda afatit të përcaktuar.

Në pikën 10, parashikon që kryetari i bashkisë vendos dhe shpall fitues subjektin me pikët më të larta, për lidhjen e kontratës së qirasë pas përfundimit të procesit të vlerësimit.

Pika 11, rregullon publikimin e fituesit në ambientet e bashkisë, në rastet kur në konkurrim marrin pjesë më shumë se një subjekt..

Pika 12, parashikon të drejtën e subjekteve pjesëmarrëse në konkurrim për të paraqitur ankim ndaj shpalljes së fituesit, si dhe detyrimin e institucionit për të dhënë përgjigje me shkrim brenda afatit të përcaktuar.

Pika 13, përcakton që pas përfundimit të procedurave, bashkia shpall publikisht fituesin dhe lidh kontratën e qirasë me afat 5-vjeçar, jo më vonë se fillimi i sezonit të gjetisë.

Në pikën 14, përcaktohen rregullat për vlerën e qirasë, duke parashikuar se ajo nuk mund të jetë më e ulët se vlera fillestare e përcaktuar, ndërsa për

Relacion shpjegues për projektvendimin: "Për përcaktimin e dokumentacionit, afateve dhe procedurës së konkurrimit për dhënie me qira të zonës së gjetisë, mbarëstimit dhe ripopullimit"

zonat e mbarështimit dhe/ose ripopullimit ajo përfshihet në qiranë e zonës së gjuetisë.

Në pikën 15, ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Mjedisit. Projektvendimi do të dërgohet për mendim tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor si dhe tek Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk do të ketë efekte shtesë financiare në buxhetin e shtetit, pasi implementimi i tij nuk do të kërkojë financime shtesë nga ky buxhet.

MINISTRI

Sofjan JAUPAJ

Relacion shpjegues për projektvendimin: "Për përcaktimin e dokumentacionit, afateve dhe procedurës së konkurrimit për dhënien me qira të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit"